

LegalNews

Tetor 2018
October 2018



I. Ndryshime në legjislacionin për qëndrimin e të huajve në Shqipëri

Më datë 03.10.2018, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 569 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 513, datë 13.06.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar" ("Vendimi"). Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 143, datë 09.10.2018 dhe ka hyrë në fuqi pas botimit.

Ky Vendim përaftron pjesërisht kuadrin ligjor vendas për shtetasit e huaj me Direktivën 2004/114/KE, datë 13 dhjetor 2004, "Mbi kushtet e pranimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllimi studimi, trajnime pa pagese ose shërbime vullnetare", Direktivën e Këshillit 2003/86/KE, datë 22 shtator 2003, "Mbi të drejtën e bashkimit familjar", Direktivën e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009, "Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta, me qëllim pune tepër të kualifikuar".

Vendimi sjell një sërë ndryshimesh për sa i përket dokumentacionit që shtetasit e huaj duhet të paraqesin pranë autoriteteve të pikave të kontrollit kufitar dhe zyrave përkatëse të migracionit si dhe në ambasada dhe zyra konsullore. Me ndryshimet që ka pësuar Vendimi, kërkohet që shtetasit e huaj që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, të paraqesin në pikat e kontrollit kufitar vërtetim lidhur me mjetet financiare.

I. Amendments to the legislation on the residence of foreigners in Albania

On 03.10.2018, the Council of Ministers has approved Decision no. 569 "On some amendments and additions to the Decision no.513, dated 13.06.2013, of Council of Ministers, "On determining the criteria, procedures and the documentation on the entry, residence and treatment of foreign citizen in the Republic of Albania" as amended" ("Decision"). The Decision has been published in the Official Gazette no.143, dated 09.10.2018 and has entered into force after its publication.

This Decision partially approximates domestic legislation on foreigners with Directive 2004/114/KE, dated 13 December 2004, "On the conditions of admission of third-country citizens for the purpose of study, free trainings or voluntary services", Directive of Council 2003/86/EC dated 22 September 2003 "On the right of the family reunion", Directive of Council 2009/50/EC, dated 25 May 2009, "On the conditions of entry and residence of third-country citizens, with the aim of highly qualified employment".

The Decision makes some amendments regarding the documentation required by the cross border authorities and the relevant migration authorities as well as the embassies and counselor offices. Pursuant to the amendments made to the Decision, foreigners who enters into Albanian territory shall submit to border authorities a certificate regarding their financial means.

Gjithashtu, parashikohet shprehimisht që aplikimi për vizë do kryhet kryesisht on-line. Për sa i përket, rinovimit të lejes së qëndrimit, pranë autoritetit përkatës, veç dokumentacionit të mëparshëm shtohet edhe vërtetimi i regjistrimit të vendbanimit nga Zyra e Gjendjes Civile në juridiksionin territorial të së cilës është regjistruar vendbanimi i deklaruar. Në këtë kuptim, shtetasit e huaj duhet që pas pajisjes me leje qëndrimi, me vlefshmëri të paktën 1 vjeçare, të regjistrohen pranë Zyrës së Gjendjes Civile ku kanë vendbanimin.

Parashikime të tjera të Vendimit lidhen me dokumentacionin për trajtimin me leje qëndrimi të kategorive: punonjës të transferuar, studentë, nxënës shkolle, bashkim familjar, si dhe rastet humanitare, leje qëndrimi në kushte favorizuese e lehtësuese, etj.

II. Ndryshime ne Ligjin për Ndërmjetësimin

Më 17 Maj 2018, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 26/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.02.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" ("Ligji"). Ligji u publikua në Fletoren Zyrtare nr. 85, datë 12.06.2018 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Ligjvënësi ka parashikuar disa risi ne Ligj, më të rëndësishmet nder to janë paraqitur më poshtë.

Furthermore, the Decision expressly provides that the visa application shall be submitted mainly on-line. With regard to the procedures for the renewal of the residence permit, the foreigner, along with the other documentation shall submit also the certificate of registration in the Civil Register Office which has jurisdiction over the area of residence. In this context, it should be noted that the foreign citizens, after the issuance of the residence permit, with a validity term at least of 1 (one) year, must be registered near the Civil Registry Office of their residence area.

Other provisions of the Decision are related with the documentation for obtaining the residence permit for the following categories: transferred employees, students, family reunion, humanitarian cases, residence permit in favorable and facilitating conditions, etc.

II. Amendments to the Law on Mediation

On May 17, 2018 the Albanian Parliament approved the Law no.26/2018 "On some additions and amendments to Law no. 10 385, dated 24.2.2011 "On mediation in dispute resolution" ("Law"). The Law was published with the Official Gazette no. 85, dated 12.06.2018 and has entered into force 15 days after the publication.

The legislator has provided for several novelties in the Law, the most important of them displayed herein below.

Struktura e Ligjit ka ndryshuar duke shtuar dy nene te reja, përkatësisht një nen te dedikuar për "*Objektin e ligjit*" dhe tjetri lidhur me "*Përkufizimet*".

Procesi i licencimit është ndryshuar thellësisht dhe nenet 4 e 5 janë të tërësisht të rishkruara. Sipas ndryshimeve të fundit të këtyre neneve, ndërmjetësi i cili duhet të jetë shtetas shqiptar te paktën 28 vjeç, duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme për të aplikuar për licencë:

- të ketë kryer programe të studimeve të ciklit të dytë;
- të ketë eksperiencë profesionale jo më pak se 3 (tre) vjet;
- të mos jetë dënuar për kryerjen me dashje të veprave penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- të ketë përfunduar me sukses trajnimin fillestar dhe provimin kualifikues.

Organi përgjegjës për licencimin është Ministria e Drejtësisë, e cila, brenda 45 ditëve nga data e aplikimit lëshon licencën për personin e interesuar. Pas marrjes se licencës dhe regjistrimit në Regjistrin e Ndërmjetësve, ndërmjetësi mund të ushtrojë aktivitetin e tij si person fizik ose si person juridik.

The structure of the Law has been changed by introducing two new articles respectively one dedicated to the "*Object of the law*" and one dedicated to "*Definitions*".

The licensing process has been deeply amended with articles 4 and 5 totally rewritten. According to the latest amendments of these articles, the mediator that should be an Albanian citizen of at least 28 years old, must meet the following to apply for a license:

- to have completed second cycle study programs;
- to have professional experience of not less than 3 (three) years;
- not to have been convicted for intentional criminal offenses by a final court decision;
- to have successfully completed the initial training and qualifying exam.

The responsible body for the licensing is the Ministry of Justice, which, issues the license to the interested person within 45 days from the application date. After obtaining the license and registration in the Register of Mediators, the mediator may exercise its activity as natural or legal person.

Në rast se ndërmjetësi nuk e ushtron aktivitet për 2 vite të njëpasnjëshme, licenca përkatëse do të hiqet dhe ndërmjetësi do të çregjistrohet nga Regjistri i Ndërmjetësve. Në mënyrë që të vlerësohet ushtrimi i aktivitetit, do të merren në konsideratë të dhëna nga autoritetet tatimore, ekzistenca e çështjeve të trajtuara si edhe trajnimet e vazhdueshme.

Një risi e këtij Ligji është neni 6/1 i quajtur "Ankimi", i cili i jep të drejtën ndërmjetësve të ankimojnë në gjykatën kompetente të çështjeve administrative brenda 45 ditëve vendimin mbi refuzimin e licencës ose urdhrin e Ministrit të Drejtësisë për vendosjen e masës disiplinore për heqjen e licencës.

Masat disiplinore ndaj ndërmjetësuesve jepen nga Bordi Disiplinor, i cili është i përbërë nga 5 anëtarë, 4 prej të cilëve janë të zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve dhe 1 nga Ministria e Drejtësisë, me afat 5 vjeçar. Bordi Disiplinor, në mënyrë proporcionale me llojin dhe seriozitetin e shkeljes, vendos mbi masat disiplinore, të cilat mund të jenë si më poshtë:

- Vërejtje me shkrim;
- Urdhëron ndërmjetësit për të kryer trajnim vazhdues shtesë, përfshirë trajnim në etikë dhe/ose trajnim në një fushë të veçantë të ndërmjetësimit;
- Vendos gjobë nga 50.000 lekë deri në 300.000 lekë;
- Pezullon përkohësisht aktivitetin për një periudhë deri në një vit;

In case that the mediator does not exercise the activity for 2 consecutive years, the respective license shall be removed and he/she shall be deregistered by the Register of Mediators. In order to evaluate the exercise of the activity, the data from tax authorities, the existence of the matters dealt with and the ongoing mediator's trainings will be considered.

A novelty of this Law is article 6/1 "Appeal", which provides for the right of mediators to appeal to the competent administrative court within 45 days from the date of notification of the license's refusal or the order of the Minister of Justice for imposing disciplinary measures for the revocation of the license.

The disciplinary measures on mediators are issued by the Disciplinary Board, which consists of 5 members, of whom 4 are elected by the General Meeting of Mediators and 1 by the Ministry of Justice, for a term of 5 years. The Disciplinary Board, proportionally to the nature and gravity of the violation, imposes disciplinary measures, which may be the following:

- Written reprimand;
- Orders the mediator to undertake additional training, including ethical training and/or training in a particular field of mediation;
- Imposes fines varying from ALL 50.000 to ALL 300.000;
- Suspending temporary, the activity for a period of up to one year;

Në raste te posaçme të parashikuara nga Ligji, Bordi Disiplinor ka të drejtë t'i propozojë Ministrisë së Drejtësisë heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit.

Dispozita të tjera të Ligjit kanë të bëjnë me detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit, Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve, kriteret e përzgjedhjes dhe detyrat e Kryetarit të Dhomës, si edhe shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit, të cilat, në rast se nuk parashikohet ndryshe me marrëveshje, do të paguhen në mënyrë proporcionale nga palët.

In specific cases provided for by law, the Disciplinary Board has the right to propose to the Ministry of Justice the removal of a license for the exercise of the mediation profession.

Other provisions of the Law relate to the duties and responsibilities of the Ministry of Justice, National Chamber of Mediation, General Meeting of Mediators, the selection criteria and the duties of the Chairman of the Chamber, as well as the costs of the mediation procedure, which, if not otherwise provided by agreement, will be paid proportionally by the parties.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit
Gjeologji Miniera
Tirana | Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 263,900 professionals are committed to becoming the standard of excellence.